



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:113618

Datë: 06.12.2024

Numri i dokumentit: 06561813

C.nr.363/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Berkan Hamza dhe me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve: V.M, H.M, S.M, dhe R.M, që të gjithë nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson F.S, avokat në Prizren, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 2,623.64 euro, jashtë seance me datë 05.12.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT E BAZUAR kërkesëpadia e paditësve: V.M, H.M, S.M, dhe R.M.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit V.M nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Prill - Dhjetor 2021 në shumën prej 128.82 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 484.15 euro, në shumën e përgjithshme prej 612.97 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 17.04.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit H.M nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Prill - Dhjetor 2021 në shumën prej 128.82 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 484.15 euro, në shumën e përgjithshme prej 612.97 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 17.04.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses S.M nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t'ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Prill - Dhjetor 2021 në shumën prej 128.82 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 484.15 euro, në shumën e përgjithshme prej 612.97 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e

paraqitjes së padisë 17.04.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit R.M nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Prill - Dhjetor 2021 në shumën prej 128.82 euro, si dhe për periudhën kohore Janar - Tetor 2022 në shumën prej 484.15 euro, në shumën e përgjithshme prej 612.97 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 17.04.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

VI. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit V.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore 01 Janar – 31 Mars 2021, mbi shumën e gjykuar prej 128.82 euro, deri në 171.76 euro, dhe atë në shumën prej 42.94 euro.

VII. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit H.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore 01 Janar – 31 Mars 2021, mbi shumën e gjykuar prej 128.82 euro, deri në 171.76 euro, dhe atë në shumën prej 42.94 euro.

VIII. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses S.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore 01 Janar – 31 Mars 2021, mbi shumën e gjykuar prej 128.82 euro, deri në 171.76 euro dhe atë në shumën prej 42.94 euro.

IX. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit R.M, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë: për periudhën kohore 01 Janar – 31 Mars 2021, mbi shumën e gjykuar prej 128.82 euro, deri në 171.76 euro, dhe atë në shumën prej 42.94 euro.

X. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve V.M, H.M, S.M, dhe R.M, ti paguaj shumën prej 301.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

#### A r s y e t i m

Paditësit V.M, H.M, S.M, dhe R.M në këtë gjykatë me datë 17.04.2024, përmes të autorizuarit të tyre F.S, avokat në Prizren, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit– Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit. Duke theksuar se theksuar se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të nënshkruar me datë 18.04.2017 dhe 22.01.2022 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, punonjësve të arsimit në Kosovë i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e inflacionit vjetor, të iu paguhen të ardhurat sipas rritjes ekonomike të inflacionit vjetor. Ka kërkuar nga gjykata që ta detyroi të paditurën që paditësve V.M, H.M, S.M, dhe R.M në emër të kompensimit të shtesë mbi bazën e përqindjes të inflacionit të ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore 1. Janar - Dhjetor 2021 në shumën prej 171.76 euro, si dhe 2.për periudhën kohore Janar – Tetor 2022 në shumën prej 655.91 euro. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 18.09.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Paditësja ka ushtruar padi në gjykatë më 08.04.2024, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e përqindjes së inflacionit, për periudhën kohore nga 01.01.2021 – 31.10.2022, në mbështetje të Kontratës Kolektive, me kërkesëpadi ka kërkuar kompensim përtej vlefshmërisë së Kontratës Kolektive. I njëjti ka theksuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, kërkesëpadi e paditësve është parashkruar. Duke shtuar se padia e paditësve nuk është e bazuar në asnjë bazë të vlefshme juridike, rrjellimisht nga provat e paraqitura dhe pretendimet e parashtruara me padi, paditësja nuk ka arritur ta argumentoj themelësinë e kërkesëpadisë ndaj të paditurës. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, 398 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësit të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Sakip Bellaqa” në fshatin Pataqan i Epërm, Komuna e Rahovecit. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditëses Sh.Xh është në shumën prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e

*inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve V.M, H.M, S.M, dhe R.M, i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën II, III, IV, dhe V të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlogaritjes së bërë në këtë mënyrë:*

Për periudhën Prill - Dhjetor 2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 128.82 euro ( $421 * 3.4\% = 14.31 * 9 = 128.82$ ).

Për periudhën Janar 2022 - Tetor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësve në vitin 2022 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 522.54euro ( $421 * 11.5\% = 48.41 * 10 = 484.15$ ).

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë të paditësit, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtuftjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”,* ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.*

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për pjesën e kërkesëpadisë të paditësve për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datën 31.03.2021. Padia e paditësve është dorëzuar më datën 17.04.2024, ndërsa kërkesëpadia e paditësës përfshin periudhën kohore prej datës 01.01.2021 deri me datën 31.10.2022. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.* Prandaj edhe kërkesa për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri

me datën 31.03.2021, dhe atë për 3 muaj është jashtë afatit 3 vjeçar, andaj kërkesëpapia për këtë periudhë në shumë prej 42.94 është refuzuar për shkak të parashkrimit.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashkrimit të padisë në këtë gjykatë (date e prashtrimit të padisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që e paditura t’ia kompensojë paditësve shumën si në pikën X. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 301.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 260.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 41.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.363/2024, më datën 06.12.2024

Bashkëpunëtore profesionale  
Adelina Çmega

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.